REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 209/19
Datë/Datum. 10.05.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: Nr. i prokurimit **00220-19-2198-1-1-1**
Nr i brendshëm: **220 19 012 111**

Sa i përket tenderit për **"Furnizim me Barna nga Lista Esenciale per nevoja të SHSKUK" – LOT 6**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

MEDICAL GROUP SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Fehmi Agani 69/B nr.10,
(Adresa)
Prishtinë, Kosovë — ***10000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*
038 713 333 — ***038 713 323***
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Skender Kutllovci MD. MSc.
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

skutllovci@medicalgroup-ks.com
(Adresa elektronike)

09 Maj 2019
(Data e parashtrimit të ankesës)

S. Kutllovci
(Nënshkrimi dhe vula)

MEDICAL GROUP SH.P.K. PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Avokat Fisnik SALIHU dhe Avokatura "Ramaj & Palushi" LLC, Kushtrim Palushi, Visar Ramaj
(Emri i avokatit)

Rruga Qamil Hoxha Nr. 13/5, 10 000 Prishtinë, Kosovë.
(Adresa e plotë)

+383 44 210 889
(Numri i Telefonit)

_____
(Numri i faks-it)

info@ramajpalushi.com; visar.ramaj@gmail.com, fis.salihu@gmail.com, kpalushi@ramajpalushi.com,
(Adresa elektronike)

09 Maj 2019
(Data e parashtrimit të ankesës)

_____
(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Kemi të bëjmë me Njoftim për Kontratë, Procedurë e Hapur, për furnizim, "Furnizim me Barna nga Lista Esenciale per nevoja të SHSKUK", për Aktivitetin e Prokurimit me Nr i prokurimit 00220-19-2198-1-1-1.

Kemi të bëjë me procedurë të hapur ku kriter për dhënien e tenderit është Tenderi i Përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

27 Prill 2019 – Medical Group ShPK dërgon Kërkesë për Sqarime të Dosjes së tenderit. Kjo duke dëshmuar se Dosja e Tenderit është e paqartë dhe krijon hapësirë për abuzime.

02 Maj 2019 – Në përgjigje në Kërkesë për Sqarime, për LOT 6 Autoriteti Kontraktues nuk bënë sqarime të Dosjes së Tenderit dhe nuk përgjigjet në kërkesën për sqarim, kjo duke lënë në tërësi të pasqaruar çështjet e ngritura kundër Kërkesave të Dosjes së Tenderit, duke qenë

MEDICAL GROUP SH.P.K. PRISHTINË

se një kriter nga Kërkesa e Dosjes së Tenderit është diskriminuese. 03 Maj 2019 – Operatori Ekonomik Ankues Medical Group paraqiti kërkesë për Rishqyrtim. Kjo duke dëshmuar së Dosja e Tenderit është e paqart dhe krijon hapsirë për abuzime.

07 Maj 2019 – AK merr vendimim duke mos sqaruar dhe duke mos vendosur fare për kërkesën për rishqyrtim të OE Medical Group SHPK. Duke theksuar së Specifikat e produktit në Listën Esenciale e lejojnë devijimin e njësive prej 2000-6000IU në përqendrim 0.4ml. Vendimi thekson "luteni t'i referoheni Listës Esenciale, AK, SHSKUK Nuk ka kompetencë dhe të drejtë për ndryshimin e listës esenciale për barna dhe materiale medicinale".

09 Maj 2019 – Paraqitet kjo Ankesë në OSHP.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					Jo	X	

Nuk aplikohet procedura e hapjes së tenderëve.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po					Jo	X	

Ankesa paraqitet në raport me Specifikat e Dosjes së Tenderit.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

MEDICAL GROUP SH.P.K. PRISHTINË

Neni 28 Specifikimet teknike – Specifikimet Teknike të Dosjes së Tenderit janë të paqarta, dhe lënë mundësinë e interpretimeve diskriminuese, sikurse ka ndodhur në të kaluarën.

Dosja e tenderit përmban specifika të produkteve të caktuara të kompanive të caktuara, kjo në kundërshtim me Nenin 28 të Dosjes së Tenderit, dhe të njejtat specifika diskriminuese nuk kanë kurrfar mbështetje shkencore.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi – përshkrimi në Dosjen e Tenderit i produkteve specifike të një produkti specifik, dhe duke e lënë qëllimshëm në mënyrë të paqartë, kjo duke përdorur diskriminimin kundër tjerëve.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në përputhje me kërkesat dhe Specifikimin e detyrueshëm të Dosjes së Tenderit, Aneksi 1, për LOT 6 është kërkuar:

LOW MOLECULAR WEIGHT HEPARIN shiring e mbushur/sol per inj 2000IU-6000 IU / 0.4ml s.c &i.v

Në këtë fazë është me rëndësi esenciale që Autoriteti Kontraktues të bëjë sqarimet e nevojshme për qëllime të parandalimit të eliminimeve kundërligjore të ofertave specifike dhe ndërhyrjes në prishjen e konkurencës në favour të kompanive të caktuara.

Pretendimi Ankimor 1

Zakonisht, Autoriteti Kontraktues, në tenderët e kaluar, ka tentuar të eliminojë kompanitë më serioze globale vetëm bazuar në volumin në të cilin është bari (kriteri prej 0.4 ml). Kriteri kryesor që e përcakton dozën për produktin Low Molecural Weight Heparine është numri i njësive ndërkombëtare (IU), i cili duhet të jetë mes 2000 – 6000 IU ashtu siq kërkohet nga LE, Në anën tjetër, çfarë volumi ka bari është tërësisht i parëndësishëm nga aspekti klinik dhe farmaceutik, mjekësor, pra a janë 2000 IU (njësi ndërkombëtare) të tretura në 0.2 ml tretësirë, apo në 0.4 ml, është plotësishtë e parëndësishme.

Në lidhje me këtë praktikë të paligjshmedhe diskriminuese, rasti është trajtuar më herët edhe në OSHP. Sipas Vendimit OSHP-së PSH.nr. 136/17, për të njejtën lëndë e specifikacion, është sqaruar se të gjitha produktet të cilat ofertojnë brenda përqëndrimeve *2000IU - 6000IU* janë tërësisht të përgjegjshme. Pra, produktet të cilat ofertojnë me 2000

MEDICAL GROUP S. PRISHTINË

IU (njësi ndërkombëtare), 2500IU (njësi ndërkombëtare), 3000IU (njësi ndërkombëtare), 4000 IU (njësi ndërkombëtare), 5000 IU (njësi ndërkombëtare), apo 6000 IU (njësi ndërkombëtare) të gjitha janë të përgjegjshme për qëllime të tenderit.

Për më tepër, Sipas Vendimit OSHP-së PSH.nr. 136/17 gjithashtu është sqaruar se volumi prej 0.2 ml apo 0.4 ml ku është dispersuar doza e njësive Ndërkombëtare IU nuk është kriter i dosjes së tenderit dhe paraqet devijim të vogël për të cilin një kompani nuk mund të eliminohet. Kjo pasi në vitet paraprake, Autoriteti Kontraktues është furnizuar me produkt prej 2000 IU dhe në dozë prej 0.2 ml.

Rrjedhimisht, të gjitha produktet që posedojnë Autorizim Marketing, dhe të cilat janë Brenda njësive ndërkomëbëtare të kërkuara prej 2000 IU deri në 6000 IU janë të pranueshme.

Autoriteti Kontraktus refuzon të përgjigjet në këtë faktë dhe këtë nuk e bënë as në ofrimin e sqarimeve, dhe as në Vendimin për Rishqyrtim.

Prentedimi Ankimor 2

Për më tepër, dosja e tenderit duhet të sqarohet dhe të përcaktohet nëse produkti me 2000IU, 3000IU apo 5000IU do të trajtohet njejtë sa i përket çmimit. Sa më e lartë të jetë përqëndrimi i Njësive Ndërkombëtare IU, aq më i lartë është çmimi. Rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktues duhet të tregojë se si do i trajtojë ofertat. Duhet të caktohet se kosto e një produkti prej 2000 IU është përgjysmë më i lirë se një produkti me 4000 IU (njësi ndërkombëtare).

Andaj, në këtë fazë, dhe në dritë të vendimeve të plotfuqishme, u kërkojmë që të sqaroni dosjen e tenderit, dhe të përcaktoni se për sa kohë plotësohet numri i njësive ndërkombëtare IU të përcaktuara, volumi në të cilën janë të përqëndruara këto njësi nuk është kriter i përgjegjshmërisë pasi nuk ka asnjë rëndësi klinike dhe farmakologjike vetëm se krijon monopol.

Prandaj, bazuar në agumentet dhe shkeljet e elaboruara më lartë, OE Medical Group ShPK kërkon me respekt nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të merr këtë:

VENDIM

I. APROVOHET Ankesa e OE Medical Group si e bazuar.

MEDICAL GROUP SH.P.K. PRISHTINË

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Në rast të diskriminimit MEDICAL GROUP SHPK do të pësojë dëme të konsiderueshme materiale dhe jomateriale, sikurse fitim të humbur dhe prishje të reputacionit afarist. Si rrjedhojë, OE MEDICAL GROUP SHPK do të jetë e detyruar të veprojë në mbrjtje të interesave të saj ekonomike dhe juridike duke kërkuar kompenzimin e plotë të dëmeve të shkaktuara.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

MEDICAL GROUP SH.P.K. PRISHTINË